

SHPRESA ISMAJLI

FJALËFORMIMI NË VEPRËN E BUZUKUT

Ky punim, është një përpjekje për të trajtuar mënyrën se si ndërtohen fjalët në tekstin më të vjetër të shqipes, për të dhënë në formë të përmbledhur një përshkrim për mënyrat dhe tipat fjalëformues të shqipes së shek. XVI, në mënyrë që të arrijmë të njohim më mirë e më thellë strukturën fjalëformuese të gjuhës së asaj kohe. Kështu, mund të themi se qysh te libri i parë shqip dalin një numër i konsiderueshëm mjetesh fjalëformuese, shumica nga të cilat kanë përdorim të gjerë edhe në shqipen e sotme.

Edhe në librin e Buzukut, sikurse në shqipen e sotme, prejardhja është mënyra kryesore e formimit të fjalëve. Në bazë të vëzhgimeve tona, të bëra mbi korpusin e nxjerrë nga vepra e Buzukut, gati gjysma e fjalëve të këtij libri, saktësisht rreth 48% të tyre, janë fjalë të prejardhura (kryesisht me prapashtesim dhe me parashtesim).

Prapashtesat, sikurse në shqipen e sotme, edhe te Buzuku, janë më të shumta në numër dhe më prodhimtare. Prejardhja prapashtesore është mënyra kryesore fjalëformuese në këtë libër, që do të thotë se shumica e fjalëve të Buzukut, konkretisht rreth 58% të tyre, janë të formuara me anë prapashtesash. Në librin Meshari na dalin gjithsej 33 prapashtesa, të cilat kanë formuar një numër të madh fjalësh. Prapashtesimi në këtë libër ka vepruar sidomos në fushën e emrave dhe foljeve, më pak te mbiemrat dhe ndajfoljet.

Më së shumti e gjejmë të përdorur prapashtesën *-o*, me të cilën janë formuar 43 folje, shumica nga temat emërore. Prapashtesat *-no*, *-to*, *-zo* dhe *-xo* formojnë vetëm disa folje te Buzuku. Në fushën e emrave, më prodhimtaret na dalin prapashtesa *-i*, me të cilën gjejmë 17 emra e vetëm një folje, me *-im* 13 emra, ndërsa me prapashtesën *-(ë)ni* kemi gjetur 8 emra. Nga prapashtesat që formojnë emra vepruesish më prodhimtarja është *-(ë)s* me të cilën formohen 27 emra, me *-tar* 9 emra dhe një mbiemër, prapashtesat *-tor/ -tuor*, *-or/ -uor* janë pak prodhimtare. Te Buzuku gjejmë edhe prapashtesat e zvogëlimit *-zë* (e cila formon 6 emra, një mbiemër dhe një ndajfolje) dhe *-th* (me të cilën kemi gjetur 2 emra). Prapashtesa të tjera, të përdorura më pak te Buzuku janë: *-shim* *-imë*, *-isht*, *-ti*, *-më*, *-ar*, *-esë*, *-ë*, *-ti*, *-tyrë*, e ndonjë tjetër, të cilat kanë formuar një numër të vogël fjalësh të këtij libri.

Megjithëkëtë, po të bëhet një krahasim me mjetet fjalëformuese të shqipes së sotme, numri i prapashtesave që dalin te Buzuku është relativisht i kufizuar, kufizim që vjen, edhe nga përmbajtja e kufizuar e tekstit, po edhe nga fakti se në shqipen e shek. XVI dhe të shekujve të mëvonshëm, vendin e

formimeve me prapashtesa, sidomos në fushën e emrave, e zinte një mënyrë tjetër formimi, pikërisht emërimi i mbiemrave prejpjesorë të gjinisë asnjansë¹. Gjuha e sotme shqipe, në krahasim me gjuhën e Buzukut, gjatë rrugëtimit të saj nëpër shekuj, për zgjerimin dhe pasurimin e leksikut të saj me njësi të reja, i ka zgjeruar shumë mënyrat dhe i ka shumëfishuar mjetet fjalëformuese, qoftë duke shfrytëzuar gjerësisht mjetet fjalëformuese të gjuhës popullore, qoftë duke krijuar të reja.

Edhe formimet me parashtesa na dalin të pasura në shqipen e Buzukut. Në këtë libër gjejmë të përdorura 23 parashtesa, shumica nga të cilat nuk janë prodhimtare. Te Buzuku përdorim mjaft të shpeshtë ka një parashtesë *n-* (përdoret në 23 formime, prej tyre 11 folje), përgjithësisht pa kurrfarë funksioni, e cila në shqipen e sotme nuk është aq prodhimtare (ndeshet në formimin e një numri foljesh, tema fjalëformuese e të cilave nuk ndeshet si fjalë më vete). Mjaft prodhimtare na dalin edhe parashtesat: *për-* (me 22 formime, 16 folje dhe 6 mbiemra) dhe *pa-* (me 17 fjalë, 15 mbiemra, një emër dhe një ndajfolje), ndërsa *z-*, *m(ë)-*, *sh-*, *shpër-*, *mbas-*, *etj.* nuk janë prodhimtare. Disa nga këto parashtesa, gjatë zhvillimit të shqipes janë gjallëruar e janë bërë shumë prodhimtare, e disa e kanë humbur krejtësisht prodhimtarinë dhe nuk janë më aktive në shqipen e sotme. Por, siç dihet, gjatë kësaj kohe, shqipja e zgjeroi numrin e parashtesave, produktivitetin, përdorimin dhe funksionin e tyre.

Në librin e Buzukut, sikurse në shqipen e sotme, mënyra parashtesim dhe prapashtesim njëkohësisht, nuk është prodhimtare. Me këtë mënyrë i gjejmë të formuara foljet *mbukuroj* e *përkatënoj* dhe emrin *përderës*.

Në gjuhën shqipe, ka një numër fjalësh që tradicionalisht në gramatikat e shqipes trajtohen si formime parashtesore, te të cilat parashtesat ndryshojnë kategorinë leksiko-gramatikore të fjalëve me të cilat bashkohen (nga një temë emërore formohet një folje), p.sh. *përmend*, *përbuz*, *përdor* etj. Në këto raste fjala është formuar jo thjesht me parashtesim, po me një mënyrë të përzier, *parashtesim dhe prejardhje pa ndajshitesë* (si te *shosh* < *shoshë*, *ndryshk* fol. < *ndryshk* em.)². Kështu, krahas formimeve me parashtesa dhe prapashtesa, ku parashtesa dhe prapashtesa janë të shprehura materialisht, kemi edhe formimet parashteso- prapashtesore, ku parashtesa është e shprehur materialisht, ndërsa prapashtesa nuk shprehet³. Me këtë mënyrë fjalëformimi te Buzuku janë formuar këto folje: *përtërij*, *përmend*, *ngjall*, *zbardh* dhe *zdrit*. Sipas E. Hysës, arsyeja themelore që formime të këtij tipi t'i vështrojmë si formime

¹ E. Hysa – L. Xoxe, *Vëzhgime për formimin fjalëve te "Meshari" i Gjon Buzukut*, në Seminari për Gjuhën Shqipe, 22/1, f. 238.

² *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, ASHSH, Tiranë, 2001, f. 61.

³ E. Hysa, *Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe*, në Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, II, f. 79.

parashteso- prapashtesore me parashtesë të pashprehur materialisht, është se parashtesat nuk kanë rol klasifikues gjatë formimit të njësive të reja, kjo është veçori karakteristike për prapashtesat⁴.

Në gjuhën shqipe ekzistojnë një numër fjalësh, të cilat nga pikëpamja kuptimore janë të motivueshme, të prejardhura, megjithëse nga pikëpamja strukturore paraqiten pa ndonjë ndajshitesë fjalëformuese⁵. Këto formime ndryshe quhen me prapashtesë zero, karakteristikë e të cilave është mosrealizimi fonetik i prapashtesës, e cila nënkuptohet dhe shpeshherë mund të shtohet lehtësisht⁶. Pikërisht kjo prapashtesë zero është formanti i tyre fjalëformues, e cila ndryshon njëkohësisht kuptimin dhe kategorinë leksikogramatikore të temës fjalëformuese⁷. Edhe pse formimet me konversion dhe ato me prapashtesë zero formohen pa ndonjë ndajshitesë të realizuar fonetkisht, lënda leksikore e shqipes tregon se formimet me prapashtesë zero janë qartësisht të dallueshme nga formimet me konversion, sepse kalimi nga pjesë të tjera të ligjëratës në folje, në këto raste, nuk bëhet për shkak të kushteve sintaksore të fjalës që shërben si temë fjalëformuese⁸. Me këtë mënyrë te Meshari i kemi gjetur emrat *masë* (nga *mat/mas*) dhe *kullosë* (nga *kullot/kullotë*) dhe foljet: *krypetë* (nga emri kripë), *qelbet* (nga emri qelb), *dergjetë* (nga emri dergjë), *mënihem* (nga *mëni*), *shëndoshem* (nga mbiemri *i shëndoshë*), *zemërkeqem* (nga *zemërkeq*) dhe *zemërmirem* (nga *zemërmirë*).

Pas prejardhjes, nyjëzimi është mënyrë mjaft prodhimtare te Buzuku (me mbi 18 % të formimeve), pas të cilit vijnë konversioni, përngjitja, mënyrat e përziera dhe kompozimi, me më së paku formime. Te Meshari, nyjëzimi i pjesoreve me prapashtesën *-m* na ka dalë më produktivi (me 59 formime), pastaj i atyre më *-unë* (me 42), ndërsa pjesoret më *-në*, *-të* dhe *-ë* nuk janë produktive. Ndërsa, me nyjëzim të temave ndajfoljore i gjejmë të formuar vetëm mbiemrat *i afërë*, *i largë* dhe *i shumë*. Në shqipen e sotme, mbiemrat *i afërë*, *i largë*, *i shpeshë* na dalin të zgjeruar me prapashtesat *-m* dhe *-të*. Këto parashtesa kanë për qëllim që t'i diferencojnë akoma më shumë mbiemrat nga ndajfoljet përgjegjëse⁹.

Mbiemrat e emëruar, ose të formuar me konversion, janë shumë të shpeshtë te Buzuku. Me këtë mënyrë fjalëformimi janë formuar rreth 17 % të fjalëve të këtij teksti. Buzuku dhe autorët e tjerë të vjetër kanë përdorur emërimin e mbiemrave në trajtën e gjinisë asnjëse ose femërore për të

⁴ E. Hysa, Libri i cituar, f. 80.

⁵ Gramatika e cituar, f. 68.

⁶ L. Buxheli, *Formimi i foljeve në gjuhën letrare shqipe*, Tiranë, 2008, f. 71.

⁷ L. Buxheli, Libri i cituar, f. 299.

⁸ Libri i cituar, f. 72.

⁹ I. Arapi, *Tipat strukturorë të mbiemrave në veprën "Çeta e profetëve" të Pjetër Bogdanit*, S. F. 1990/1, f. 47.

shënuar nocione abstrakte, meqë në atë kohë emrat abstraktë të formuar me prapashtesa ishin të rrallë. Këto mbiemra e partcipe të substantivuara kanë pasur përgjithësisht atë funksion formativ që në shqipen moderne sidomos të shkrimit e kryejnë kryesisht emrat derivate, veçanërisht ato të sajua me sufikset *-je*, *-im*, *-esë*, të cilat kanë zhdukur për një pjesë të madhe ato forma¹⁰.

Krahas kthimit të mbiemrave në emra, edhe te Buzuku vërehet edhe procesi i kundërt, kthimi i emrave në mbiemra. Në veprën e Buzukut mbiemra të tillë janë: *plak* “zakoni *plak*”, *gjakës* “nierinë *gjakës*”, *gjykatës* “pleq *gjykatës*”, *punëtore* “ditë *punëtore*”.

Përngjitja nuk është mënyrë fjalëformuese prodhimtare në veprën Meshari. Me këtë mënyrë janë formuar afër 7% të fjalëve të këtij libri. Përngjitja ka vepruar kryesisht te ndajfoljet (26) dhe përemrat (19), te disa numërorë (5), lidhëza (7) dhe parafjalë (3).

Ndër fjalët e formuara me mënyra të përziera, që përbëjnë rreth 6.5 % të fjalëve të Mesharit, formimet me nyjëzim dhe prapashtesim janë më të shumtat, pas tyre vijnë ato nyjëzim dhe përngjitje. Kështu, me nyjëzim dhe prapashtesën *-shim* janë formuar 15 mbiemra, me nyjëzim dhe *-të* kemi të formuar 19 mbiemra. Ndërsa formimet me nyjëzim dhe prapashtesat *-(ë)në*, *-(ë)m*, *-(ë)rë* dhe *-ë* janë më pak prodhimtare (me nga 3 a 4 fjalë).

Me nyjëzimin dhe përngjitje (të togut parafjalë + emër), në librin e Buzukut kemi 19 mbiemra, ndërsa me nyjëzim, prapashtesim dhe prapashtesim njëkohësisht kemi gjetur vetëm mbiemrat *i përmortshim*, *i përhërshim* dhe *e pambarshimeja*.

Kompozitat në veprën Meshari janë të pakta, vetëm rreth 4 % të fjalëve të këtij libri janë formuar me kompozim. Te Buzuku i gjejmë 9 kompozita emërore dhe 9 kompozita mbiemërore, kompozita foljore kemi gjetur vetëm 3, ndërsa numërorë të përbërë kemi hasur 8. Megjithëse të pakta, kompozitat te Buzuku, na tregojnë se kompozimi ka qenë prirje e hershme e gjuhës shqipe, të cilën ajo e ka gjallëruar dhe përsosur vazhdimisht në rrjedhë të zhvillimit të gjuhës. Kështu, në shqipen e sotme, kompozimi, pas prapashtesimit, është mënyra më prodhimtare për formimin e emrave të rinj.

Analiza e strukturës fjalëformuese të veprës së Buzukut na ka dhënë një pamje pak a shumë të plotë të formanteve, tipave dhe mënyrave të formimit të fjalëve në shqipen e shek. XVI, si dhe mundësinë për të bërë krahasime me shqipen sot. Mund të themi se qysh te libri i parë i njohur shqip, na dalin pothuajse të gjitha mënyrat fjalëformuese që përdoren në shqipen e sotme, si dhe një numër relativisht i madh mjetesh (formantesh) fjalëformuese, disa nga të cilat janë më shumë, e disa më pak prodhimtare.

¹⁰ E. Çabej, *Studime gjuhësore*, VI, Prishtinë, 1988, f. 61.